

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT:

“Shfrytezim i kombinuar me miniere netokesore dhe kariere siperfaqesore i qymyrit bituminoz dhe bitum natyral”







Subjekti: “Selenice Bitumi” Sh.a

Vendndodhja: Selenice, Vlore

Pergatiti materialin : “Eko- Studio- Projekt” sh.p.k

Tirane, 2019

PERMBAJTJA

-  Hyrje
-  Baza ligjore
-  Metodika e vleresimit te mjedisit
-  Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere , perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Ndaj eshte e nevojshme qe shoqeria te ndergjegjesohet per ta mbajtur sa me paster mjedisin ku jetojme duke marre masat e duhura per trajtimin e mbetjeve si dhe emetimin e gazeve te demshem ne atmosfere qe gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteve te ndryshme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Shfrytezim i kombinuar me miniere nentokesore dhe kariere siperfaqesore i qymyrit bituminoz dhe bitum natyral”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*

- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « *Per largimin publik te mbeturinave* »
- Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « *Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis* »
- Udhezim nr.3 date 19.11.2009 '*Per metodologjine e raportit te VNM*'
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja* ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis*”.

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti “**Selenice Bitumi**” Sh.a eshte rregjistruar prane QKR me numer NIPT-ti K16815202M me perfaqesues ligjor Z. Patrick Pascal. Vendi i ushtrimit te aktivitetit eshte Selenice, Vlore.

Pershkrimi i aktivitetit

Vendurimit i bitumit ne Selenice, Vlore eshte vene nen shfrytezim qe prej viteve 1870 nga Banka Otomane, me pas nen administrimin e shoqerise franceze te bitumit me qender France, te shoqerise Italiane SIMSA me qender ne rome deri ne vitet 1943, deri ne perfundim te viteve 2000 nga shteti Shqiptar dhe ne Shkurt te viti 2001 aksionet e shoqerise "Selenice Bitumi" sh.a, u privatizuan 100% nga shoqeria Franceze KLP Industrie.

Shfrytezimi i vendburimit ka filluar me germime siperfaqesore dhe me punime te cekta afer siperfaqes. Me pas ka vijuar me punime nentokesore, duke filluar nga lart-poshte (nga afer siperfaqes ne drejtim te thellesise). Fillimisht shfrytezimi eshte bere me punime horizontale, pastaj punime te pjereta (dishenderi) dhe ne vitin 1963 u vu ne shfrytezim pusi vertikal me thellesi rreth 150 ml.

Aktualisht punimet e pergatitjes dhe te shfrytezimit te bitumit natyral dhe zhavorrit bituminoz kane arritur ne nivelin -53 ne sektorin e pusit qendror ne zonen mineral mbajttese Kume-Muriz, te ndodhur ne pjesen qendrore te vendburimit te bitumit Selenice.



Zona ka nje terren kodrinor nje kuote me te ulet + 40m ne krahun verior e cila ne krahun jugor fillon ngrihet gradualisht dhe shkon + 110m. Ne krahun lindor terreni ngrihet gradualisht deri ne kuoten +80m, ndersa ne krahun perendimor ngrihet menjehere me kuoten +60m e cila eshte nje koder qe kufizon zonen e shfrytezimit nga qyteti i Selenices.

Brenda zones kalon prroi i "Kabanave" i cili ka drejtimin jug-veri, kalon ne fushen e Selenices dhe me pas derdhet ne lumin e Vjoses.

Bazuar ne ndertimin gjeologjik te vendburimit, prerja e tij perbehet nga depozita argjilo-alevrolitike, ranore, rana, konglomerate dhe zeje.

Deri ne nivelin +30m qe parashikohet te zhvillohen punimet e zbulimit dhe shfrytezimit me karriere, parashikohen te takohen kryesisht formacionet ranore, konglomerate pak te cimentuara dhe ne raste te vecanta konkretione te cimentuara forte, zeje dhe pak argjile dhe alevrolite. Ranoret e cimentuar, konglomerate dhe alevrolite pa te cara, jane te qendrueshem, ndersa bitumet dhe zhavorret bituminoz jane akoma dhe me te qendrueshme. Argjilat jane homogjene, neper to vrehen pasqyra rreshqitese. Disa argjila permbajne dhe pjese ranori nga te cilat varen dhe vetite plastike te tyre.

Argjilat kane kufi plasticiteti, peshe specifike dhe peshe voluminore te ngjashme me ato te alevroliteve.

Per shkak se ne qender te zones kalon perroi i "Kabanave" per shfrytezimin e zones jane hapurr dy karriera Nr.1 dhe Nr.2 te cilat jane te vecanta dhe ndahen nga njera tjetra nga ky prua qe rrjedh me drejtimin veri-jug.

Karrierat do te shfrytezohen ne dy faza:

Faza 1

Konstruksion ne hapje, pergatitjen dhe shfrytezimin e zones ne lindje te perroit te "Kabanave" dhe ne ane te karrieres Nr.2.

Faza 2.

Konstruksion ne hapje, pergatitjen dhe shfrytezimin e zones perendimore te perroit te "Kabanave" dhe ne ane te karrieres Nr.1.

Kjo rradhe pergatitje dhe shfrytezimi eshte zgjedhur per arsye se ne ane te karrieres Nr.2 ka filluar me shpejte prodhimi i bitumit natyral dhe zhavorrit bituminoz.

Sistemi i perroit do te konsistoje ne eleminimin e kthesave qe jane aktualisht dhe drejtimi dhe thellimin e tij ne vende te ngushta per perballimin e prurjeve maksimale te ujit gjate periudhes se dimrit me rreshje te dendura, me qellim mos hyrjen e tyre ne karriere.

Per mbrojtjen e karrieres nga ujerat e rreshjeve te shiut jashte kufijve te karrieres, ne te gjithë perimetrin e saj do te behen kanale per drejtimin e ujerave drejt perroit te "Kabanave".



Elementet e karrierave:

Karriera Nr.1

- Gjeresia e siperme sipas shtreses 240-310m,
- Gjeresia e poshtme sipas shtrirjes 120-190m
- Gjeresia e siperme sipas renies 720m
- Gjeresia e poshtme sipas renies 580m
- Thellesia e karrieres 85m
- Lartesia e shkalles 5m
- Kendi I pjeresise se skarpates 42°

Karriera Nr.2

- Gjeresia e siperme sipas shtreses 240-320 m
- Gjeresia e poshtme sipas shtrirjes 180-200m
- Gjeresia e siperme sipas renies 410m
- Gjeresia e poshtme sipas renies 320m
- Thellesia e karrieres 60m
- Lartesia e shkalles 5m
- Kendi I pjeresise se skarpates 42°



Zbulimi i sterilizimit dhe shfrytëzimi i bitumit natyral dhe zhavorrit bituminoz do të bëhet nga lart poshtë duke filluar nga niveli 80 m deri në nivelin me të ulet të zbulimit dhe të shfrytëzimit +10m.

Drejtimi i avancimit të frontit të zbulimit të sterilizimit dhe të prodhimit të mineraleve në shkallën e karrierës do të jetë nga lindja në perëndim, ndërsa zhvendosja e shkallëve të zbulimit dhe të prodhimit do të jetë nga veriu në drejtim të jugut.

Për germimin dhe ngarkimin e sterilizimit që do të dalë nga zbulimi, si dhe për germimin dhe ngarkimin e bitumit natyral dhe zhavorrit bituminoz do të përdoren tre eskavatore me kapacitet kocke 1.5m³ dhe 2.0 m³, me motor diesel dhe sistem ecje me zinxhira.

Volumi i transportit do të jetë sa volumi i germimit 2100 m³/dite. Distanca mesatare e transportit do të jetë 1500 m.

Punimet e transportit në karriere do të kryhen me automjete vetshkarkuese e kapacitet të kazanit 12 m³.

Duke patur parasysh dhe koeficientin e gadishmerisë, për transportin e sterileve dhe të prodhimit mineral (bitum natyral dhe zhavorr bituminoz) do të nevojiten tre automjete me kapacitet të kazanit 15 m³.

Hapja e transeve kapitale dhe prerese dhe mbajtja e sheshit të punës në gjendje për levizjen e automjeteve do të bëhet krahas germimit me eskavatore dhe buldozer. Sheshimi i sterileve në sheshin e depozitimit do të bëhet me buldozer. Për kryerjen e punimeve të mesipërme do të nevojitet një buldozer me fuqi 250 kf.

Nga punimet e zbulimit që do të kryhen në karriere për zbulimin e mineralit të bitumit natyral dhe zhavorrit bituminoz do të gërmohen, transportohen, depozitohen dhe sistemohen në sheshin e stokimit rreth 2100 m³ steril/dite.

Depozitimi i sterileve që do të dalë nga punimet e zbulimit në karriere do të bëhet në dy sheshe. Sterili që do të dalë nga zbulimi në karriere Nr.2 e cila do të hapet e para, do të depozitohen në "Proin e ngjalave" mbi sterilet që kanë dalë nga zhvillimi i punimeve të kërkimit të zbulimit të bitumit dhe zhavorrit bituminoz në sektorin e P. Qendror gjatë viti të shfrytëzimit të minierës me punime nentokesore.

Sheshi i depozitimit është terreni inproduktiv i zhveshur plotësisht. Kuota e sheshit është me të ulet se sheshi i P.Qendror dhe lejon depozitimin e sterileve me lartësi të konsiderueshme rreth 30 m.

Distanca e sheshit të depozitimit nga karriera Nr.2 është rreth 500m.

Sterilet qe do te dalin nga zbulimi ne karriren Nr.1 do te depozitohen ne hapsiren e krijuar ne karriren Nr.2, duke bere dhe rigjenerimin e siperfaqes se zbuluar dhe shfrytezuar ne kete karriere.

Distanca e sheshit te depozitimit nga karriera Nr.1 eshte rreth 500m.

Ne sheshin e depozitimit do te punoje vazhdimisht nje buldozer me thike me fuqi 250 kf i cili do te bej sheshimin e sterileve qe shkarkohen nga kamionat si dhe do te mirembaje ne gjendje pune rrugen e transportit brenda sheshit te depozitimit.



Lendet ndihmese qe do te perdoren per hapjen, pergatitjen dhe shfrytezimin e kesaj karriere jane kryesisht karburante, vajra hidraulike dhe graso qe do te perdoren me qellim mirefunksionimin e mjeteve te germimit, transport dhe ngarkim te sterilit dhe mineralit te bitumit dhe zhavorrit bituminoz.

Furnizimi i mjeteve me karburant do te behet nga distributori i shoqerise Selenice Bitumi Sh. A qe eshte ne afersi te karrieres.

Gjithashtu gjate hapjes dhe shfrytezimit te karrieres ka grumbullime te ujrave nentokesore dhe siperfaqesore, dhe per pasoje, per zhvillimin normal te punimeve te zbulimit dhe te prodhimit eshte e nevojshme qe keto ujera te nxirren jashte karrieres, duke perdorur pompa zhytесе shllami. Pompa eshte e pajisur me kalanxh i cili ben te mundur stakimin e pompes ne menyre automatike ne nivelin e deshiruar te ujit.

Produktet e dala nga shfrytezimi i karrierave jane:

1. Produkti i ndermjetem dhe perfundimtar

Produkti i ndermjetem qe do te nxiret nga karriera do te jete bitumi natyral me karakteristika fiziko-kimike si me posht:

Nr.	Emri i komponenteve	Njesia e matjes	Sasia
1	Permbajtja e Karbonit	%	76.00 – 82.00
2	Permbajtja e Sqfurit	%	7.00 – 8.50
3	Permbajtja e Azotit	%	0.68 – 0.71
4	Permbajtja e Oksigjenit	%	2.26 – 4.19
5	Permbajtja e Karboideve	%	30.00 – 75.00
6	Permbajtja e Asfalteneve	%	14.00 – 54.00
7	Permbajtja e Reshires	%	3.00 – 21.00
8	Permbajtja e Vajit	%	4.00 – 34.00
9	Permbajtja e Bashkimit te mineraleve	%	2.00 – 30.00

2. Produktet perfundimtare

Produktet perfundimtare do te jene bitum I pasturar dhe zhavorri bituminoz.

Karakteristikat fiziko – kimike te zhavorrit bituminoz

Nr.	Emri i komponenteve	Njesia e matjes	Sasia
1	Permbajtja e Karbonit	%	45.00 – 70.00
2	Permbajtja e Sqfurit	%	7.30 – 8.20
3	Permbajtja e Azotit	%	0.82 – 0.83
4	Permbajtja e Hidrogjenit	%	7.50 – 8.00
5	Permbajtja e Lageshtise	%	9.50 – 20.00
6	Fuqia kalorifike	K. k/kg	4500 – 5500

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Pozita gjeografike

Vlora është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë. Vlora është qyteti i dytë më i madh portual pas Durrësit, me një popullsi afërsisht 200,000. Ndodhet në jugperëndim të Shqipërisë, në Detin Adriatik dhe është qendra e Rrethit të Vlorës dhe të Qarkun së Vlorës.

Kushtet klimatike

Klima e Rajonit është tipike mesdhetare me një dimër të lagësht e të ngrohte dhe me një vere të nxehte e cila arrin deri në 40 grade. Në përgjithësi në rrethin e Vlores, regjimi i presionit të ulet zgjat pak dhe periudha me kohe të mire është me e gjate se në pjeset e tjera të vendit. Faktoret që përcaktojnë klimën e kësaj zone janë:

- Pozicioni gjeografik dhe afërsia me detin që zbut efektet ekstreme të klimes.
- Ndikimi i cikloneve dhe anticikloneve që rregullojnë klimën e krejt rajonit.
- Larmia e formave të relievit dhe drejtimi i përcaktuar mirë i vargmaleve dhe luginave.

Temperaturat mesatare për Vloren ndryshojnë nga 16,1 në 17,7 grade. Në Vlore mungojnë temperaturat e uleta që regjistrohen në zonat e tjera të vendit. Temperaturat më të uleta, si në të gjithë zonën bregdetare të Shqipërisë, regjistrohen gjatë Janarit-Shkurtit.

Sasia mesatare e reshjeve arrin 1200mm/vit, pjesa më e madhe e të cilave në nëntor-dhjetor. Muajt më të thatë janë Korriku, Gushti dhe Shtatori. Deti dhe format e relievit ndikojnë shumë në shpërndarjen e reshjeve në rrethin e Vlores. Luginat e Shushices, Dukatit, Borshit e Vjoses shërbejnë gjatë gjithë vitit si zona të shkëmbimit klimaterik të zonave të bregdetit me ato në brendësi. Kjo është arsyeja e shirave të bollshme pranë zonave malore në krahasim me zonat e

tjera te rrethit. Ndersa ne zonen bregdetare te qytetit sasia mesatare e reshjeve eshte 1000mm/vit e ne Orikum 1314mm/vit, ne zonat malore si Llogara e Dukat, reshjet arrijne perkatesisht 2500 e 2453mm/vit. Numri mesatar i diteve me lageshti eshte 105 - 147dite ne vit. Debora eshte nje dukuri teper e rralle ne bregdet, ndersa ne zonat malore eshte nje dukuri normale qe fillon qe ne nentor. Pozicioni gjeografik i rrethit te Vlores ben qe zona te jete nen ndikimin ererave te fuqishme, qe jane te ndryshme per nga forca dhe prania gjate vitit. Erera te zakonshme jane puhite detare, te cilat ndihen me shume gjate bregdetit. Rrethi i Vlores ne pergjithesi dallohet per ererat e forta, kjo per shkak te konfigurimit te relievit dhe gjirit te Vlores.

Gjeologjia

Rajoni i Vlores i takon zonës paleogjeografike jonike, e cila në përfundim kufizohet me zonën e Sazanit dhe në lindje me zonën e Krujës. Një njësi e veçantë, më e re se të parat, është ultësira pranadriatike që mbivendoset mbi të tria zonat e lartpërmendura. Zona jonike gjatë zhvillimit të vet paleogjeografik ka qenë një basen detar i thelle nga jorasiku në paleogjen, kurse dy zonat fqinje, Sazani dhe Kruja, kanë qenë basene detare të cekëtta, shpesh të dala dhe mbi ujë.

Në fillim të miocenit të mesëm, rreth 15 milion vjet më parë, zona jonike u përfshi nga proceset e rrudhosjes dhe të malformimit, duke u shndërruar dalëngadalë në stere. Në këtë kohë u formuan disa breza të rrudhosur mbiujorë me pamje antiklinale, si brezi antiklinal i Çikës, ai i Kurveleshit, etj.

Midis tyre mbeten breza nënujore në trajtë sinklinale, si ai i Shushicës, ku vendoset edhe Kuçi, Memaliajt etj. Në fund të miocenit, rreth 5 milion vjet më parë, ndodhi një rrudhosje tepër e fuqishme, që e shndërroi ultësirën pranëadriatike në strere me mjaft rrudha antiklinale e sinklinale.

Flora dhe fauna

Mbulesa bimore e rajonit është dëmtuar shumë nga shpyllëzimet për toka bujqësore (bukë), nga prerjet për dru zjarri, djegiet e bëra nga barinjët dhe nga kullotja pa kriter e bagëtisë (dhive). Bimësia më e përhapur janë shkurret e tipit mesdhetar (makja) të përbëra nga : sqina (xina), koçimarja, përralli, mersina, shqopa, cfaka (bezga), thrumja, sherebeli etj. Në luginat përhapje të gjerë ka dhe hilqja dhe rrapit. Në pjesët e larta rritet bredhi e pak pisha. Ka gjithashtu kullota të pasura verore.

- **Kafshe e egra**

Nga kafshët e egra më shumë gjendet derri i egër dhe lepuri, të dëmtuar rëndë nga gjuetia. Haset edhe dhelpra, kunadhja, dreri (sorkadhja) gjendet ne pyllin e

mbrekullueshem te Zarelit si dhe ne pjesen e poshtme te fshatit si ne Shen Thanas, Perroi i Thate etj, shqarthe (macja e eger), lunderza (vidhra) ne lumin Shushice. Nga shpendët përhapje), kukumjaçka (bufi), qyqja, si dhe harabeli, gushkuqi dhe lloje të ndryshme shpendësh. Ne lumin e Shushicës gjenden me shumice trofta, ndërsa ne përrenjtë qe derdhen ne lume ka shume krap te madhësive te vogla, si dhe ngjala. Ne terrenin me shkurre ka zvarranike te përmasave dhe llojeve

te ndryshme, te pastuduara ende. Ka gjarpërinj me madhësi edhe mbi 2 merta, ndodhen gjithashtu edhe nepërka nje gjarpër i rrezikshëm sulmues, astriti dhe gjarpërinj me ngjyra e madhësi te ndryshme. Ne te gjitha pyjet me shkurre te bie ne sy nje numër i madh breshkash.

Rrjeti hidrike dhe ujerat

Uji eshte nje pasuri natyrore me vlera te medha kombetare. Ai ka perdorim te madh ne bujqesi, ne industri dhe per furnizimin e qendrave te banuara. Rajoni i Vlores eshte nje rajon bregdetar i cili laget nga deti Adriatik edhe ai Jon, Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lumi i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Por rajoni eshte i pasur edhe me burime ujore , zona e Kuçit ka pasuri të shumta ujërash, si pak fshatra të Kurveleshit ku numërohen rreth 157 burime ujore. Pasuritë më të mëdha janë burimet e Lëpushës me 550 l/s, dhe buronjat e Kuçe me 300 l/s ; një nga burimet më të mëdha karstike të Shqipërisë jugore. Buronjat e Kuçe shkarkojnë ujërat nëntokësore që grumbullohen në masivin karstik të Kurveleshit të Sipërm, i cili gjendet rreth 600 m më lartë se vendi ku dalin Buronjat. Buronjat përfaqësojnë një objekt me rëndësi turistike për gjithë rajonin.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikesht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne toke.

Ndikimi i mundshem	Pasojat ne mjedis
1 Shqetesim i tokes per shkak te hapjes se karrieres dhe minieres dhe shfrytezim te bitumit natyral dhe qymyrit bituminoze	Ulje e siperfaqes dhe largim i sasise se mbuleses e cila do te rikthehet ne karriere,
2 Vazhdim i ngjeshjes se pjesshme te tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe automjeteve te transportit si kamione etj.	Ngjeshja e tokes nga levizja e automjeteve dhe mjeteve gjate punimeve te shfrytezimit dhe atyre te reja do te limitohet brenda siperfaqes se kerkuar.
3 Erozion minimal ne kohe me reshje ne pjeset anesore te karrieres.(buzet e karrieres)	Shpatet e karrieres me pjerresi,behet shkak qe grimcat e tokes te ekspozohen ndaj agjenteve atmosferike duke u shkeputur dhe levizur kryesisht drejt brendesise se karrieres dhe trupave ujore ne afersi te objektit.
4 Ndotja e tokes si pasoje e avarive te	Kjo mund te vije si pasoje e rrjedhjes se

mekanikes .

lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit jo te madh te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive ,ndotja do te jete ne sasi te vogla.

- 5 Vibracion si pasoje e shfrytezimit.

Gjykuar nga volumi i punimeve do te jete nje vibracion normal teknologjik vetem ne nje zone te ngushte gjate shfrytezimit.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne ajer

Ndikimi i mundshem

Pasojat ne mjedis

- 1 Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet, ngarkim transportit.

Sasia e gazeve e NOx dhe SOx qe do te shkarkohet eshte standart i teknologjise se automjeteve qe do te perdoren gjate punimeve te parashikuara.

- 2 Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.

Rritja e nivelit te zhurmave nuk do te krijojte probleme per banoret, vetem per faunen. Gjithsesi operacionet e punes do te jene te limituara ne kohe dhe nje pjese e tyre do te kryhen nentoke.

- 3 Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit.

Ky fenomen do te jete me i dukshem gjate stines se thate ,ne sasi te limituara per shkak te volumit te punimeve dhe do te shqetesojte kryesisht faunen ne zone, pasi qendrat e banuara jane larg dhe bimesia e rralle.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne biodiversitet

Ndikimi i mundshem

Pasojat ne mjedis

- 1 Shqetesim i faunes ne zone

Siperfaqja e karrieres rreth saj eshte e varfer ne bimesi dhe rrjedhimisht proceset ekologjike jane minimale dhe te kufizuara.Nuk do te kemi ndonje shtim apo demtim habitati e ekosistemesh te virgjera.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme negative ne peisazh

Ndikimi i mundshem

Pasojat ne mjedis

- 1 Ndikime ne peisazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti

Nder ndikimet me evidente do te jene ndryshime te pjerresise se terrenit dhe ato vizuale te peisazhit.

Mbetjet e ngurta

Ndikimi i mundshem

Pasojat ne mjedis

- 1 Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor

Kartona,bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve.

- 2 Sterilet e gjeneruara

Do te depozitohen perkohesisht ne

vendepozitimim e percaktuar dhe do te rehabilitohen sipas planit te rehabilitimit qe ka hartuar subjekti

4. MASAT PER ELEMINIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Identifikimi i masave zbutese te propozuar ne toke

	Lloji i ndikimit	Masat e propozuara
1	Shqetesim i shtreses se tokes per shkak te shfrytezimit.	Hapja dhe nxjerrja e bitumit natyral dhe zhavoreve bituminoze eshte domosdoshmeri, respektohet rigorozisht siperfaqja dhe do te rehabilitohet ajo me pyllezim.
2	Vazhdim i ngjeshjes se pjesshme te tokes nga levizja e mjeteve te punes dhe te automjeteve te transportit si kamione etj.	Limitohet ne siperfaqe te domosdoshme dh me ndikim te perkohshem.
3	Erozion minimal ne kohe me reshje ne pjeset anesore te karrieres.	Jane hapur kanalet e mbrojtese per te minimizuar efektin erodues te ujrave te shiut.
4	Ndotja e tokes si pasoje e avarive te mekanikes .	Kjo mund te vije si pasoje e rrjedhjes se lubrifikanteve dhe karburanteve po per shkak te vellimit te vogel te punimeve dhe numrit te reduktuar te makinerive, ndotja do te jete e paperfillshme.
5	Vibracion si pasoje e shfrytezimit	Per te eleminuar vibrimin perdoret shfrytezimi me gerryerje.

Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne ajer

	Ndikimi i mundshem	Masat e propozuara
1	Shkarkim i sasise minimale te gazeve nga automjetet ,ngarkim transportit.	Mjetet e transportit kaludohen periodikisht dhe ne rast defektesh ,ato eleminohen menjehere .
2	Emetim zhurmash nga automjetet e transportit dhe mjetet e punes.	Mjetet e transportit kaludohen periodikisht dhe ne rast defektesh ,ato eleminohen menjehere Shmangjet ne maksimum renia e burise dhe kalimi shume prane qendrave te banuara.
3	Sasi pluhuri si pasoje e qarkullimit te kamioneve jashte objektit dhe transportit te mineralit.	Ne rastet e krijimit te pluhurave behet lagia e rruges me uje,kjo gjate stines se thate.

Identifikimi i masave zbutese te propozuara ne biodiversitet

Ndikimi i mundshem

- 1 Shqetesim i faunes ne zone

Masat e propozuara

Respektim te siperfaqes se dhene per shfrytezim dhe rehabilitim te saj.

Identifikimi i masave zbutese e propozuara ne peisazh

Ndikimi i mundshem

- 1 Ndikime ne peisazh dhe topografine e terrenit ku ndodhet objekti

Masat e propozuara

Respektim i siperfaqes se karrieres dhe rehabilitim gradual i saj.

Identifikimi i masave zbutese te propozuara per mbetjet e ngurta

Ndikimi i mundshem

- 1 Gjenerim i mbetjeve nga aktiviteti njerezor

Masat e propozuara

Keto mbetje trajtohen si mbetje urbane duke u grumbulluar dhe depozituar ne vendet e caktuara.

- 2 Rehabilitimi i sterileve.

Sipas planit te rehabilitimit te hartuar nga subjekti , sterilet depozitohen ne sheshdepozitim jashte kufijve te karrieres per te cilin subjekti eshte i pajisur me leje mjedisore.

Mbrojtja nga zjarri

Per nje siguri maksimale drejtuesit, kane marre te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri.

Brenda ambjentit te punes jane vendosur ne vende te dukshme pajisje te mbrojtjes nga zjarri, numrat e telefonit te zjarrfikeseve, urgjences dhe policise, si dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

Punedhenesi ka detyre:

- Te kualifikoje punonjesit, per teknologjine ne perdorim, proceset e punes dhe kerkesat teknike qe duhet te zbatohen.
- Te pranoje ne pune persona te afte nga ana shendetesore dhe mendore qe e verteton me raport mjeksor.
- Ti instruktoje punonjesit per proceset e punes qe do te kryejne.
- Ti njoh me rregulloret e sigurimit teknik ne fuqi.
- Ti njoh me rregulloren e mbrojtjes nga zjarri.
- Tju beje te ditur shkaqet e aksidenteve dhe masat qe duhet te merren per ti menjanuar ato.
- Te kualifikoje punonjesit per te qene te afte te japin ndihmen e shpejte ne raste aksidentesh.
- Te siguroje mjetet mbrojtese individuale dhe kolektive per punonjesit.
- Te monitoroje nivelin e sigurise ne pune.

Punemarresi ka detyre:

- Te kualifikohet per procesin e punes qe do te kryeje.
- Te zbatoje rregulloret e sigurimit teknik ne pune.
- Te perdore mjete individuale mbrojtese ne pune.
- Te mos lejoje qe punen e tij ta kryeje nje punonjes tjetër.
- Kur konstaton avari, merr masa per ta eleminuar ate dhe njofton menjehere drejtuesin teknik.
- Te jap ndihmen e shpejte shokut ne raste demtimi.
- Te mos perdore pije alkoolike para fillimit te punes dhe gjate kohes se punes.
- Te kontrolloje gjendjen teknike te pajisjes ne perdorim para fillimit te punes dhe pasi konstaton gjendjen e rregullt fillon punen .
- Kur nuk ndihet mire me shendet ve ne dijeni pergjegjesin dhe largohet nga fronti i punes.

Mbrojtja nga zjarri

Per nje siguri maksimale ne ambientet e karrieres nga drejtuesit e saj, jane marre te gjitha masat per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik dhe te mbrojtjes nga zjarri.

Brenda ambientit te punes jane vendosur ne vende te dukshme paisje te mbrojtjes nga zjarri, numrat e telefonit te zjarrfikeseve, urgjences dhe policise, si dhe jane marre masa per te kryer instruktimin e punonjesve ne menyre periodike.

Per “EKO - STUDIO - PROJEKT” sh.p.k